

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Irani: Presim përgjigjen përfundimtare të SHBA-së për rihapjen e Hormuzit Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/irani-presim-pergjigjen-perfundimtare-te-shba-se-per-rihapjen-e-hormuzit/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 15:43:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 15:41:17 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8a62955acc2fb6b2c87bf47a927568d05e541311b562b7bd2d4bed0692cee84c
TEKSTI	27a461ee7e6ffaa4f7378b5511af275daebe914778c4a49cdee4c4443e26ac76
PAMJA	246565100a9332421ee2838aca0b83ae0370e043cee4df7bffd446257e5e26a3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	2fd13c0909e3407c9c38561b814a712a87b712c98dc9021b7b4f1db58123927b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9c79dfe18abd067ab8b189d0d92c4d66095ab349897e5facabd5b8506753a66f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/2fd13c0909e3407c9c38561b814a712a87b712c98dc9021b7b4f1db58123927b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Bota

Irani: Presim përgjigjen përfundimtare të SHBA-së për rihapjen e Hormuzit



Edi Hallaci

27 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Irani thotë se po pret përgjigjen “përfundimtare” të Shteteve të Bashkuara ndaj propozimit të tij për rihapjen e Ngushticës së Hormuzit, pavarësisht se presidenti amerikan Donald Trump e ka hedhur poshtë publikisht ofertën, duke e cilësuar atë “të papranueshme”.

Sipas propozimit të Teheranit, Ngushtica e Hormuzit do të rihapej brenda shtatë ditësh dhe SHBA-ja dhe Irani do të rikthenin bisedimet për një marrëveshje të re. Në këmbim, Teherani kërkon që Uashingtoni të përbushë disa kushte, përfshirë heqjen e bllokadës detare ndaj porteve iraniane dhe lehtësimin e presionit ekonomik e ushtarak ndaj Iranit.

Ministri i Jashtëm iranian, Abbas Araghchi, tha se Teherani ka parë reagimin e parë të Trumpit, por ende nuk ka marrë një përgjigje zyrtare përmes ndërmjetësve.

“Pamë reagimin e parë presidenti i SHBA-së, por ende nuk na është përcjellë asgjë nga ndërmjetësit”, tha Araghchi.

Ai shtoi se Trump ka bërë deklarata të ndryshme dhe kontradiktore për këtë çështje, ndërsa Irani pret që qëndrimi përfundimtar i SHBA-së t’i përcillet përmes ndërmjetësve.

“Po presim që mendimi përfundimtar të na përcillet nga ndërmjetësit dhe do të marrim një vendim bazuar në këtë”, tha ministri iranian.

Trump e hodhi poshtë të shtunën propozimin e Teheranit për rihapjen e Ngushticës së Hormuzit, duke e cilësuar atë “të papranueshëm”.

“Ata duan të bëjnë një marrëveshje për ta hapur menjëherë ngushticën, sepse po humbasin shumë”, tha Trump. “Edhe mua më pëlqen të bëj një marrëveshje, por ajo marrëveshje nuk do të ishte e pranueshme.”

Propozimi iranian u bë publik gjatë vizitës së zyrtarëve të lartë të Teheranit në Nju Jork, ku morën pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara dhe zhvilluan kontakte me zyrtarë amerikanë.

Araghchi nuk ka bërë publike të gjitha kushtet e propozimit, por ka thënë se ato nuk përmbajnë asgjë më shumë sesa parashikohet në Memorandumin e Mirëkuptimit SHBA-Iran, të nënshkruar në qershor dhe që më pas u rrëzua pas rifillimit të luftimeve.

Sipas ministrit iranian, nëse plotësohen kushtet e kërkuara, lundrimi në Ngushticën e Hormuzit mund të rikthehet në normalitet brenda shtatë ditësh.

“Zgjedhja tani u takon Shteteve të Bashkuara”, u tha Araghchi gazetarëve gjatë vizitës në Nju Jork.

“Nuk mund të bombardosh një vend, ta kërcënosh me shfarosje, të vendosësh bllokadë detare dhe masa shtrënguese dhe më pas të presësh që siguria dhe lundrimi të rikthehen automatikisht”, shtoi ai.

Nga ana tjetër, një zyrtar i Shtëpisë së Bardhë i tha CNN se SHBA-ja po zhvillon “diskutime pozitive dhe konstruktive përmes ndërmjetësve”.

“Shtetet e Bashkuara janë në një pozicion shumë të fortë, me kontrollin e Ngushticës së Hormuzit, ndaj nuk jemi me nxitim”, tha zyrtari.

Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, mbajti një qëndrim të ngjashëm gjatë kësaj jave, duke deklaruar se çdo marrëveshje me Iranin do të kërkonte “shumë punë të vështirë gjatë një periudhe kohore”.

Nërkohë, duke cituar zyrtarë amerikanë, gazeta “The Wall Street Journal” raportoi të premten se Trump u ka thënë stafit të tij se një fushatë e re bombardimesh ndaj Iranit mund të jetë e mundur pas zgjedhjeve të ardhshme të mesmandatit në SHBA. Sipas zyrtarëve të cituar nga gazeta, qëndrimi i Trumpit mund të ndryshojë gjatë javëve të ardhshme.

CNN i është drejtuar Shtëpisë së Bardhë për një koment lidhur me këtë raportim.

Gjatë fjalimit të tij në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, Trump tha se përballë tij qëndronte një vendim i rëndësishëm: arritja e një marrëveshjeje me Iranin apo vijimi i përballjes me Republikën Islamike.

“Kam një vendim të madh për të marrë – a do të arrihet një marrëveshje me Iranin që do t’i lejojë ata të rindërtojnë dhe të krijojnë një vend shumë më të madh se sa ka qenë ndonjëherë më parë?”

“Apo ta shkatërroj Republikën Islamike dhe ta bëj shpejt, duke mos u dhënë më kurrë atyre një shans për të vrarë dhe shkatërruar njerëz dhe vende?”

Nërkohë, zëdhënësi i ushtrisë iraniane, Mohammad Akraminia, tha të dielën se SHBA-ja mund të ndërmarrë një sulm të ri ndaj Iranit për shkak të “situatës së keqe rajonale”, raportoi Reuters.

Sipas tij, Teherani është i përgatitur për çdo përballje.

LAJME TË NGJASHME



Trump e paralajmëroi Xi-në, të mos e mbështesë Iranin!

1 MIN



A mund të bëhet Bjellorusia furnizuese kryesore e SHBA-ve me potas?

4 MIN





"Ky vend e tradhtoi Hashim Thaçin", Rama nga SHBA: Nuk u bë më e mira për George Washington-in e Kosovës

1.5 MIN



"Të vijojë lufta ndaj korrupsionit"/ Nga komandant i NATO-s në ambasador në Tiranë. Media në SHBA: Si e gjen Eric Wendt Shqipërinë

3 MIN



Peng Liyuan, "arma e fuqisë së butë" e Kinës në Uashington/ Roli i veçantë i gruas së Xi Jinping gjatë vizitës në SHBA

3.5 MIN

MË TË LEXUARAT



Punë e paqëndrueshme dhe pension i hershëm, studimi zbulon lidhjen me plakjen e trurit!



Gjiganti italian i modës Gucci nxjerr në treg atlete "Made in China"!



Tanimë gjërat kanë ndryshuar/Shenjat e zodiakut që më në fund po fillojnë një kapitull të ri të jetës së tyre!



Nations League, sonte SHQIPERI vs. BJELLORUSI/Ekskluzivisht në DigitAlb!



Aksident në Fushë-Krujë/Përplasen 3 automjete, humb jetën një 19-vjeçar!



A ju ndodh të shihni të njëjtën ëndërr vazhdimisht? Çfarë mund të fshihet pas saj?




Cindy Crawford përjetoi vite të vështira për djalin e saj?



Madonna tërheq vëmendjen me fotografi provokuese, pozon me reçipeta transparente?



"The Real Housewives" përballet me kritika? A është jeta e Wayne dhe Coleen Rooney vërtet kaq autentike?



"Send Nudes"? Sydney Sweeney shfaqet provokuese në një tjetër fushatë?

EDITORI SUGJERON



Apple surprizon me risitë, AI bën gabimin e frikshëm dhe Tesla rikthen makinën që "fluturon"!



As viti i shtatë dhe as i dhjetë, ja se kur tradhtojnë çiftet në një lidhje...



Pas 8 vitesh pritjeje, Tesla Roadster rikthehet me një premtim të çmendur: Makina që mund të fluturojë?!




Një identifikim i gabuar nga AI ngriti në këmbë ushtrinë e SHBA-së, gati për sulm! Ja si ndodhi gjithçka...



Apple Watch tani "dëgjon" bisedat tuaja dhe i përmbledh për ju?! Risia që po ngre pikëpyetje...





Keni rënë në dashuri?! Apo është thjesht...



Apple më në fund palos iPhone-in dhe vjen me "iPhone Duo"... por a ia vlen 1,999 dollarë?



iPhone 18 Pro pas një jave përdorimi/ A ia vlen vërtet ta ndërroni telefonin sipas Mateo Kadriut...



Do të habiteni kur të zbuloni fuqinë e kanellës!



A mund të konsumoni kafe gjatë ushqyerjes në gjiri?! Ja se çfarë thotë studimi...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

[Kontaktimi](#)
[Marketing](#)
[Frekuencat](#)
[Aksesueshmëria](#)
[Mundësi Punësimi](#)
[Privacy Policy & Terms](#)

JavaScript is required for tabnav widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.